

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX RasoBasic i bardhë

Ngjitës dhe rrafshues



Fushat e përdorimit

Llaç ngjitës dhe rrafshues mineral, për pllaka termoizoluese polisteroli (EPS-F) për izolim termik. Trashësia e shtresës 3mm. Sipas ETAG 004. Ngjitës për pllaka termoizolimi dhe ndërtimi si psh. shkumë e fortë polisteroli i zgjerueshëm EPS-F, EPS-P, XPS, pllaka tallashi, shkumë PU. Si urë lidhëse për sipërfaqe të lëmuara betoni. Si rrafshues/lëmues për sipërfaqet tradicionale me suva çimentoje ose betoni.

Karakteristikat

- Ngjitje e lartë
- I përdorshëm në mënyrë universale

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	47190
EAN	9003304471904
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Njeshi per palete	42 Nj./Pal
Konsumi	ca. 1,4 kg/m ² /mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Prodhimi i litrave	740 L/t
Njësia e kërkesës për ujë	ca. 7 L/Nj.
Reaksioni ndaj zjarrit	A1 EN 13501-1
Kapilariteti	< 0,2 kg/m ² *min0,5
Numri i rezistencës ndaj difuzionit të avullit të ujit	5/20 (vlera e tabelës) EN 1745
Forca në lidhje	> 0,08 N/mm ²
Forca në shtypje	12 N/mm ² (28 d)
Forca në përkulje	≥ 3 N/mm ²
Përcjellshmëria termike	0,61 W/mK për P=50% EN 1745:2012 (Vlera e tabelës) 0,66 W/mK für P=90% EN 1745:2012 (Vlera e tabelës)
Moduli-E	ca. 9500 N/mm ²

RÖFIX RasoBasic i bardhë

Ngjitës dhe rrafshues

Numri i artikullit	47190
Masa vëllimore e llaçit të freskët	ca. 1700 kg/m ³
Grup llaçi	GP EN 998-1 CS IV EN 998-1 Hidrokarbure aromatike EN 998-1
Vlera e pH	13
Dëndësia e shtresës niveluese	ca. 1400 kg/m ³ B 3345
Vlera sd	ca. 0,08 m
Kapaciteti termik	ca. 1 kJ/kg K
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	ca. 1512 kg/m ³
Temperatura nëntokësore	5-30 °C
Koha e përpunimit	2 h
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.

Baza e materialit

- Rërë gëlqerore e thërrmuar me cilësi të lartë
- Çimento e bardhë (pa kromate)
- Aditivë për përmirësimin e ngjitjes
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C dhe të ngrihet mbi +30 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blözë, kripra etj. . Pllakat e xokolaturës duhet të shtrohen në mënyrë të njëtrajtshme dhe nuk duhet të jenë të lagështa.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Largoni lëndët ndarëse që formojnë shtresa filmi (vaj armature etj.). Sipërfaqet prej karbonat kalciumi ose rërë përforcojini me RÖFIX fiksues ose largojini fare. Në bazamentet e vjetra ose pa aftësi mbajtëse, pllakat termoizoluese fiksohen me tiplla. Fugat konstruktive nuk lejohet të suvatohen. Në këtë rast duhet të vendosen profile fugash, për të cilat duhen mbajtur parasysht normat e prodhuesit. Vendosja e profileve: Vendosen sipas pikave në distance rreth 50 cm njëri nga tjetri. Profile suvaje të zinkuara duhet të priten me një gershere llamarine, në rastet e profileve të trasha me një sharre dore metali.

Përgatitja

Në aplikimin me dorë një thes përziheni sipas raportit me ujë të pastër duke përdorur një mikser ose përzierës mekanik derisa të arrini një masë homogjene. Koha e përzjerjes në rast përzjerje me dorë 2 deri 3 minuta. Pas përzjerjes lëreni 10 min. në qetësi dhe pastaj përziheni përsëri.

RÖFIX RasoBasic i bardhë

Ngjitës dhe rrafshues

Keshilla per perpunimin

Për ngjitjen e pjeshme sipërfaqësore ju këshillojmë metodën me pika dhe shirita. Kjo parandalon depërtimin e ajrit. Gjerësia e pikave të ngjitësit/rrafshuesit 5 cm dhe lartësia 2 cm. Në pjesën tjetër të sipërfaqes së pllakës vendosni tri pika ngjitës. Pasi ushtrohet pakëz forcë për ta vendosur pllakën siç duhet në mur duhet të rezultojë se rreth 40 % e sipërfaqes së pllakës izoluese të jetë me ngjitës. Pllaka izoluese fiksohet me tiplla (rreth 6 copë/m²), e cila bëhet pas forcimit të ngjitësit (pas tre ditësh). Vendosja e tiplave është e këshillueshme dhe me patjetër tek pllakat izoluese XPS-R- ose EPS-P, tek montimi i tavaneve, i bazamenteve të vjetra ose tek betonet e lëmuara. Kur përdoret si rrafshues i sipërfaqes trashësia e shtresës duhet të jetë përafërsisht 3mm. Në mënyrë që të arrihet një efekt përforcues, duhet të përdoret një rrjetë përforcuese rezistente ndaj alkalis me gjerësi manshete 4x4 deri 8x8 mm. Cepat e rrjetës përforcuese janë të mbivendosura 10cm mbi nj-tj. Në hapësirat e murit si dritare ose dyer, të gjitha qoshet janë përforcuar paraprakisht me armim diagonal (rreth 20x40cm). Rrjeta përforcuese futet në shtratin e rrafshuesit dhe mbulohet me 1mm trashësi. Kur e përdorni në zonën e xokolaturës ose në kontakt të drejtpërdrejtë me ujin, përdorni paraprakisht hidroizolues. Nën këto kushte mbrojtëse, RÖFIX RasoBasic është rezistent ndaj ngricave në fasada me ngarkesë rëndese të zakonshme. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Pas një jave kohë tharje mund të aplikoni grafiaton. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Përpunimi

Ngjyra e produktit mund të ndryshojë në varësi të prodhimeve të ndryshme.

Magazinimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit min. 12 muaj, sipas Rregullores 1907/2006/EG Aneksi XVII në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti. Datën e prodhimit shiheni mbi etiketë.

Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.